



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 165, Datë 12.10.2017

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “THE BLUE STAR” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘GORICË ’ ME FUQI TË INSTALUAR 1.747 MW.

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma ”a” të Ligjit nr.43/2015, ” *Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”; neneve 5, gërma ” a”; 13 dhe 21 të ”*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të ”*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “THE BLUE STAR” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec ‘Goricë’ me fuqi të instaluar 1.747 MW,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “THE BLUE STAR” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërma ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërma ‘a’, ‘b’, ‘c’, ‘d’, ‘e’, ‘f’ “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërma ‘a’, “b” ‘c’ dhe ‘d’) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “THE BLUE STAR” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Goricë” me fuqi të instaluar 1.747 MW, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI

